

VENDIM
Nr. 319, datë 2.6.2021

**PËR CAKTIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS “NËNË
TEREZA”, SI AEROPORT REZERVË I FORCAVE TË ARMATOSURA, GJATË
GJENDJEVE PËR TË CILAT KËRKOHET MARRJA E MASAVE TË
JASHTËZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “i”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”, si aeroport rezervë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe